Procesverbal i mbledhjes date 28.10.2025

Sot në sallen e KB Devoll zhvillohet mbledhja e rradhes sipas njoftimit te dates 23.10.2025. Te pranishem ne salle Alfredi Gjata , Valbona Spaho, Imelda Cucka , Oljana Comka , Vladimir Gjyli , Genti Demcolli , Paola Spaho, Eduard Maho , Vladimir Kello , Oliver Mulla , Festim Kaso, Ilir Hoxha .

Alfredi Gjata : Vazhdojme me piken 1 . " Miratimi i rendit te dites "

Hapet votimi: 12 pro 0 kunder 0 abstenim .

Alfredi Gjata: vazhdojme me piken 2. Miratimi i procesverbalit 29.09.2025

Hapet votimi: 12 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Projekt-Vendim Nr.61 Date 22.10.2025 " Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% per bllok-ndihmën ekonomike dhe fondet e buxhetit vendor për muajin Shtator 2025."

Vladimir Gjyli:Këtu po shikoj disa familje në këtë listënkëtu janë shumë të punësuar. Kryetar, po ka dhe qytetarë të tjerë që s'kanë të ardhura mjaftueshem.

Eduard Duro: I kam bere thirrje te gjithe familjeve qe kane studente te cilet sistemi nuk i nxjer perfitues , kemi futur kushte shtese qe te japin mundesine per ta perfituar.

Hapet votimi: 12 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Projekt-Vendim Nr.62 Datë 22.10.2025 " Për miratimin e listës që do të trajtohen me subvencionim qiraje për vitin 2025."

Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 12 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Projekt-Vendim Nr.63 Datë 22.10.2025 "Miratimin e perfituesve nga program subvencioni i interesave të kredisë per strehim."

Hapet votimi: 12 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Projekt-Vendim Nr.64 Datë 22.10.2025 "Për miratimin e kerkeses se Bashkise Devoll se bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor per akordimin e ndihmes financiare per familjen e Z.Gezim Bono, banues ne fshatin Pilur, Njesia Administrative Proger, banesa e te cilit eshte djegur plotesisht si rezultat i nje shkendije elektrike ne banesen e tij.

Eduard Duro : Eshte nje rast zjari ne te cilin eshte djegur e gjithe shtepia , ne te cilin ndodhej vetem zoteria ne fjale. Mire qe bashkeshortja dhe femijet nuk ishin aty sepse do te ishin djegur. Eshte nje rast qe nuk ka shume nevoje per koment.

Hapet votimi: 12 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Projekt Vendimin Nr. 65 , date 22.10.2025 " Per miratimin e ndihmes financiare per perballimin e shpenzimeve te varrimit nga fondi rezerve i Bashkise per qytetare ne nevoje ."

Nuk ka diskutime per kete projektvendim .

Hapet votimi: 12 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Kalojme tek pikat " Te tjera"

Eduard Duro: Paraprakisht une doja tju informoja ne lidhje me projektidene e sheshit te qytetit , projektet jane duke u punuar nga arkitektet e Bashkise por une doja dhe mendime nga ana juaj , por gjithashtu do te behen edhe degjesa publike.

Vladimir Kello: Kryetar, me vjen mire dhe si banor i ketij qyteti, nje nga qytetet me te lashta te Shqiperise , uroj qe qendra te behet sa me e mire dhe sa me shpejt .

Vladimir Gjyli: Kryetar ne rregull per kete pjese do te japim me kenaqesi mendimet tona , por per sa i perket tabeles tek rrugica e Bashkise .

Eduard Duro: Neprezantimin qe do te bejme ne keto projekte do te jete edhe zgjidhja e ketij problemi .

Vladimir Gjyli: Kete te diele ishte pothuajse e pamundur te levizje per shkak te trafikut qe u krijua .

Genti Demcolli: Ti bëj një pyetje kryetarit të bashkisë. U bënë rreth dy muaj që ke vendosur në tabelën e malorëve të bashkisë, edhe pak më pak në tjetrën. E para punë, se nuk kishit mbledhjen e kaluar, siç isha unë një mbledhje përpara, nuk kishit juve. E para punës, një herë mënyra se si u mor ky vendim, le për të diskutuar. E para, e dyta. Mirë u bë dy muaj dhe nxjerrim një konkluzion. Solli më shumë benefite për këtë komunitet, për këtë zonë, për këtë lagje, për këtë, ashtu apo mos solli më shumë. Prishje qetësie, sepse mua më rezulton që kjo malorja e bashkisë këtu, përveçse tre vetave që parkojnë, ku i prishet rehatit, tre katër vetave që e kanë të kollaj. Mundësisht, po të kishin dhe shkallët e bashkisë, ashensori ishin gati ta futnin makinën brenda, të tjerëve si sjell ndonjë benefit. Dhe për mendimin tim, po të ishte me dy sense, mos lejoheshe. Parkimi zgjidheshin të gjithë hallet e botës, sepse fillojmë që nga e diela. Problematika e saj dhe rrugës poshtë sjell këtë që sapo përmendi Miri. Vazhdojmë dhe në përditshmëri që duhet kur njeriu del në. të mëngjes apo në drekë të kthehet në shtëpi, sidomos ne të lagjes që na prek, që na influencon. Duhet të bëjmë me plan nga do i djemtë që nga s'doj djemtë pastaj. Pastaj ndodhi me ca probleme, pastaj konfliktime me policira e me gjëra e me gjëra, sepse juve këto nuk i

mendoni. Juve të privilegjuarit e pushtetit i keni këto. Domethënë, lini dhe emisarët tuaj në një qoshe të caktuar, ku ndodhin konflikte, që këtë lëre, këtë zëre, këtë fale, këtë toleroje. Më kupton? Kështu që, para se të merrni vendime, ndodhen me rrugët përbri. I shkrepet dikujt hiqja, i shkrepet dikujt vere tabelën. Pyetja ime, që mos e zgjat shumë, është e para një herë kur u mor vendimi që u vunë tabelat. U bë një studim nga specialistë të mirëfilltë. Me komunitetin që influencohet drejtpërdrejt, sepse juve jeni thjesht kalimtarë këtu katër orë. Ne që jetojmë për ditë këtu, e ndjejmë. Shto dhe kusuret e pazarit. Për ato një mijë lekëshe që mblidhen, që nuk justifikojnë as pastrimin, shto të tjera, shto të tjera, shto të tjera, shto kusuret e pedonales, shto kusuret e atyre bizneseve lokale bare. Që parkojnë si të munden ku të munden dhe hapën mbyllë hyrje daljet e petonales dhe kjo lagje është bërë e pajetueshme. Po dhe këto vendime që janë. Prishin çdo sens mase, thashë dhe e përmend, është bërë. Vend për abuzimin nga policia me gjoba është bërë, domethënë privilegji i vetëm është vetëm për tre makina, katër makina që janë rehat përpara derës së bashkisë. Çfarë do bëhet me këtë dhe çfarë konkluzioni nxorët juve pas dy muajsh? U përmirësua apo u përkeqësua jeta e zonës të re?

Eduard Duro: Do te rregullohet tek projekti i rri qe do te behet per qytetin . Duhet gjetur nje vend i rri edhe per pazarin.

Oljana Comka: Po per vijezimin e asfaltit e rruges Hocisht -Bilisht do te behet gje?

Eduard Duro: Aty nuk ka as 5 metra rruge dhe vijezimi nuk lejohet . Aty aksidentet vijne nga shpejtesia.

Alfredi Gjata: Kemi nje kerkese nga banoret e fshatit Miras per nderimin e emrit te rruges " Bilbil Laci"

Eduard Duro: Une nuk jam pro qe te hiqet emri i ketij zoterie dhe te vendoset emri i nje zoterie tjt , pasi mbase te dy mund ta meritojne , por eshte nje vendim qe eshte marre tashme dhe ne do te na duhet nje pergjigje me e detajuar nga sektori i urbanistikes i cili eshte marre me kete projektvendim.

Mbledhja deklarohet e mbyllur !

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Alfredi Gjata

Sekretar i Këshillit
Kostandina Brahollli